



INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS

Përmbledhje mujore e aktiviteteve nga IPK – Korrik 2025

Menaxhimi i ankesave

IPK gjatë muajit korrik 2025 ka pranuar dhe ka menaxhuar me 285 ankesa. Prej tyre 195 ankesa që janë klasifikuar si shkelje disiplinore dhe janë përcjellë për t'u trajtuar në Drejtorinë për hetime të brendshme dhe verifikim të së kaluarës në Policinë e Kosovës, kurse 89 nga to janë përcjellë në Departamentin e Hetimeve në IPK më dyshimin për veprimtari penale .

Gjithsej

Për javë

Për ditë

Numri i ankesave

285

71

9.1

Aktivitete në fushën e hetimeve

Bazuar në mandatin e paraparë me legjislacionin në fuqi, IPK kryen hetime penale dhe disiplinore ndaj punonjësve të Policisë. Gjatë muajit korrik 2025 Departamenti i Hetimeve në IPK ka pranuar 89 raste për hetim penal dhe në kuadër të autorizimeve ligjore ka dhënë rekomandimin për suspendim në interes të hetimit për 22 punonjës të Policisë së Kosovës kurse ka arrestuar 9 të dyshuar.

Aktivitetet e këtij Departamenti janë shprehur në mënyrë tabelore si në vijim:

Indikatori (numri)	Të dhëna për muajin korrik 2025
Kallëzime penale të parashtruara në Prokurorinë e Shtetit	12
Raporte të veçanta të parashtruara në Prokurorinë e Shtetit	4
Raporte informuese të parashtruara në Prokurorinë e Shtetit	5
Raste të proceduara në DHB, DPP-PK dhe Arkiv-IPK	21
Rekomandime për suspendim	22
Të arrestuar	9

Aktivitete në fushën e inspektimit

Objekt i veprimtarisë së IPK-së është inspektimi i strukturave e funksioneve në PK, për të siguruar llogaridhënie, efektivitet e efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore e procedurave standarde operuese. Departamenti i Inspektimit në përmbushje të mandatit ushtron mbikëqyrje të vazhdueshme policore përmes inspektimeve.

Gjatë muajit korrik 2025 inspektorët e IPK-së kanë qenë të angazhuar në këto inspektime:

Fusha e inspektimit	Lloji	Statusi
Menaxhimi i punësimit dytësor në Stacionin Policor- Podujevë	Jashtëzakonshëm	Final
Menaxhimi i punësimit dytësor në SPMK - Gjilan	Jashtëzakonshëm	Final
Reagimi në thirrjet e qytetarëve dhe raportimi i aktiviteteve	I rregullt	I publikuar
Vlerësimi i performancës së Stacionit Policor të Prizrenit	I rregullt	Në proces
Përdorimi i teknologjisë për matjen e shpejtësisë së lëvizjes	Jashtëzakonshëm	I publikuar
Vlerësimi i performancës së Stacionit Policor të Mitrovicës Jug	I rregullt	Në proces
Administrimi i automjeteve të sekuestruara	Jashtëzakonshëm	Në proces